



Projekti: Përforcimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjore për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare

Shkup, 26.09. 2017

Në kuadër të Projektit, u mbajt Konferenca Ndërkombëtare për falimentim dhe likuidim

Më 25 dhe 26 shtator 2017 në Shkup u mbajt Konferenca e parë Ndërkombëtare për falimentim dhe likuidim. Organizator i Konferencës është "Projekti për përforcimin e kapaciteteve administrative për zbatimin e kornizës ligjor për falimentim dhe likuidim të shoqërive tregtare", i cili realizohet me mjete të Instrumentit për Asistencë Para-Aderimit (IPA) të Bashkimit Evropian dhe realizohet në kuadër të Ministrisë së ekonomisë.

Në hapjen e konferencës, në të cilën morën pjesë ekspertë nga BE-ja, rajoni dhe vendi, të pranishmit i përshëndeti udhëheqësi i ekipit të projektit Krasin Dimitrov, Ministri i Ekonomisë Kreshnik Bekteshi dhe Ambasadori i Bashkimit Evropian, Samuel Zbogor.

Sipas fjalëve të udhëheqësit të ekipit të projektit Krasin Dimitrov, konferenca paraqet përfundimin e aktiviteteve të projektit të zbatuara gjatë 17 muajve të fundit – së pari, të analizës së kryer mbi mangësitë në legjislacionin krahasuar me legjislacionin evropian në fushën e falimentimit dhe të likuidimit, ku janë vërejtur një numër dobësish dhe lëshimesh që paraqesin pengesë për zbatimin efektiv dhe efikas të kornizës ligjore. Të gjitha këto janë diskutuar në detaje gjatë konsultimeve të shumta dhe tryezave të rumbullakëta në të cilat, me kënaqësi themi se morën pjesë rreth pesëqind përfaqësues të institucioneve relevante.



Kur është fjala për qëllimet e kësaj konference, mendoj se të gjithë mund të jemi të kënaqur nëse konkluzionet e theksuara do të gjenden në agjendën e grupit të punës, të cilin do ta formojë Ministria e Ekonomisë me qëllim të ndryshimit dhe përmirësimit të kornizës ligjore për falimentim, tha Dimitrov.

Ministri Kreshnik Bekteshi theksoi se vetë fakti që Projekti u realizua në kuadër të Ministrisë së Ekonomisë, imponoi nevojën që nga fillimi, rregullisht dhe me vëmendje të duhur t'i ndjekim aktivitetet e shumta edukative, komunikuese dhe profesionale të projektit – duke filluar nga këshillimet për procedurat e falimentimit dhe likuidimit, trajnimet dhe evenimentet e shumta – deri te tryezat e rumbullakëta në të cilat u debatua gjerësisht rreth zbatimit të legjislacionit ekzistues.

Jam i bindur se nga këto aktivitete, përveç Ministrisë së Ekonomisë, do të përfitojë edhe sektori i biznesit dhe ekonomia në përgjithësi, theksoi Bekteshi. Prandaj, do të dëshironim të vazhdojmë më tutje, të propozojmë projekte të mëtejshme në këtë fushë për të zbatuar dispozitat e reja aktuale evropiane. Sinqerisht, theksoi Bekteshi, do të doja të shpresoja që mbështetja e deritanishme, shumë e rëndësishme për ne, e Bashkimit Evropian, do të vazhdojë edhe më tutje. Kjo do të jetë shumë e rëndësishme, sepse në debatet gjatë këshillimeve dhe tryezave të shumta të rumbullakëta janë identifikuar probleme të shumta dhe të ndryshme në zbatimin e dispozitave ligjore. Për më tepër, propozohet edhe zhvillim i rregullativës aktuale për zgjidhje jashtë-gjyqësore, si një nga format e parandalimit të falimentimit dhe zgjidhjes së hershme të problemeve financiare të kompanive. Arritja e marrëveshjes jashtë-gjyqësore duhet të integrohet në një masë më të madhe në kornizën ligjor për falimentim, edhe atë në rastet e riorganizimit ose likuidimit. Ky ndryshim, thotë Bekteshi, pritet të ketë ndikim pozitiv në procedurën e përgjithshme ligjore.



Ministri theksoi gjithashtu se beson në mbështetjen e Bashkimit Evropian për modernizimin e kornizës ligjore për insolvencë, me një qasje dhe fokus të ri në ristrukturimin e kompanive në vend të likuidimit të tyre, dhe se në këtë drejtim, Maqedonia do të përpiqet të ndjekë këto udhëzime, si dhe udhëzimet evropiane për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e paralajmërimit të hershëm dhe fillimit me kohë të ristrukturimit, për tejkalimin e insolvencës dhe shpëtimin e vendeve të punës, ruajtjen e vlerës së pronës, e me këtë edhe të ardhmen e kompanive.

Hyrja dhe dalja nga tregu janë në zemrën e jetës ekonomike dhe janë thelbësore për funksionimin adekuat të tregjeve. Nëse ligjet për hyrje dhe dalje nga tregu janë komplekse dhe institucionet kanë mungesë të stafit dhe janë joefektive, as rregullat më të mira nga librat nuk do të ndihmojnë, tha në fjalimin e tij euroambasadori Samuel Zbogar, duke theksuar se parashikueshmëria e përmirësuar dhe marrëdhëniet tregtare me kompanitë janë shumë të rëndësishme.

Euroambasadori Samuel Zbogar theksoi se në Bashkimin Evropian, më shumë se 600 kompani po falimentojnë çdo ditë dhe se gjysma e të gjitha bizneseve në BE nuk arrijnë t'i mbijetojnë pesë vitet e para të ekzistencës së tyre. Ai theksoi se dalja nga tregu ka pasoja negative për ekonominë dhe shoqërinë dhe shkakton humbje të vendeve të punës dhe të njohurive.



Prandaj, tendenca për modernizimin e kornizës ligjore për daljen nga tregu synon të rrisë rimëkëmbjen e kompanive. Nëse ristrukturimi i kompanisë fillon me kohë, shanset janë që ajo të jetë e suksesshme dhe kreditorët do të kenë një kthim më të lartë. Në këtë mënyrë, të punësuarve dhe pronarëve iu jepet mundësia që të shpëtojnë dhe të japin një kontribut pozitiv në ekonomi, tha Zbogar.

Viteve të fundit, theksoi Zbogar, Raporti i Progresit për Maqedoninë identifikoi përmirësimin në themelimin e kompanive, por dalja nga tregu ende është e diskutueshme. Ai specifikoi se BE-ja ia ka dorëzuar 1.3 milion euro Ministrisë së Ekonomisë për ndihmë në përmirësimin e kornizës ligjore për largimin nga tregu. Masat të cilat kohëve të fundit i paraqiti Qeveria për rritjen ekonomike parashikojnë edhe ndihmë për ristrukturimin e kompanive në vend të likuidimit të tyre. Kjo është në përputhje me ndihmën që BE-ja ia ka dhënë vendit dhe na jep besimin se do të kemi reforma reale për rritjen dhe ruajtjen e vendeve të punës, tha euroambasadori Samuel Zbogar.

Në konferencë morën pjesë ekspertë nga vendi, nga Serbia, si dhe nga vendet e BE-së - Kroacia, Sllovenia dhe Finlanda. Janë paraqitur zgjidhjet ligjore në fushën e falimentimit, likuidimit dhe funksionimit të institucioneve përgjegjëse për zbatimin e tyre. Përfundimet e konferencës, së bashku me rekomandimet e projektit, si dhe të komunitetit të biznesit, do të dorëzohen për shqyrtim te grupi i punës, të cilin do ta formojë Ministria e Ekonomisë për të ndryshuar dhe përmirësuar kornizën ligjore për falimentim.